

PROCESVERBAL
nga seanca e 22-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 10.6.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: mr. Gordana Majnova (pushim vjetor).

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 22-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të vazhimit të parë të seancës së 20-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 1.6.2026.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 21-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 1.6.2026.
3. Propozim-vendim për refuzimin e Kërkesës për shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksi digjital tokësor.
4. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR JON Radio Strugë.
5. Informacion në lidhje me donacion e dhënë për IShP SBGMP 13 Nëntori Shkup, me propozim - aneksi nr. 1 ndaj Kontratës për donacion.
6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën në vijim të prokurimit publik - shërbim: byro përkthimi.
7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën në vijim të furnizimit publik - mallra: pije dhe furnizime kuzhine.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe, me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga Petar Xhurovski, miratoi Procesverbalin e vazhdimit të parë të seancës së 20-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 1.6.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 21-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 1.6.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi propozimin për miratimin e Vendimit për refuzimin e Kërkesës për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksi digjital tokësor. Ai shpjegoi se në vitin 2020 ShTR 24 Vesti ShPKNJ P Shtip, paraqiti kërkesë për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror. Në pajtim me detyrimet ligjore, Agjencia përgatiti Studim për të përcaktuar arsyeshmërinë për dhënien e lejes, në bazë të së cilës u konstatua se nuk ekziston arsyeshmëri për shpalljen e konkursit publik, për këtë arsye Kërkesa u refuzua.

Kundër vendimit të Këshillit, ShTR TV 24 Vesti ShPKNJ P Shtip ka inicuar kontest administrativ pranë Gjykatës Administrative, e cila konfirmoi vendimin e Agjencisë. Pas ankimimit në Gjykatën e Lartë Administrative, më 3 mars 2026, përkatësisht gjashtë vjet pas paraqitjes së kërkesës fillestare, u dha aktgjykim me të cilin u anulua aktvendimi i Gjykatës Administrative dhe Agjencia u urdhërua sërish të përgatisë Studim për përcaktimin e arsyeshmërisë për dhënien e lejes për transmetim televiziv përmes multipleksi digjital tokësor. Në afat prej 90-ditësh të përcaktuar në aktvendim, Agjencia ka përgatitur Studim të ri, i cili u publikua javën e kaluar. Gjetjet e Studimit përsëri treguan se nuk ekzistojnë kushte që do të arsyetonin nevojën për të shpallur konkurs publik për dhënien e një leje të tillë. Duke marrë parasysh gjetjet e Studimit, u propozua që Këshilli të miratojë Vendim për refuzim të Kërkesës së ShTR TV 24 Vesti ShPKNJ P Shtip, dhe për vendimin e marrë të njoftohet Gjykata Administrative, si provë se Agjencia ka vepruar në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë Administrative.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, e vlerësoi Studimin si një dokument të përgatitur tërësisht dhe profesionalisht dhe shprehu mirënjohje ndaj shërbimit profesional për kontributin në punë. Lidhur me çështjen e shpalljes së konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksi digjital tokësor, ai theksoi se për momentin nuk ka nevojë reale për të hapur një konkurs të tillë, duke marrë parasysh gjetjet dhe konkluzionet e përfshira në Studim. Argumentet e tij ndaj këtij qëndrim janë si më poshtë:

- Mungesa e vlerës së shtuar mediatike: Koncepti programor i "TV 24 Vesti", ashtu si dhe në televizionet e tjera që tashmë transmetojnë përmes multiplekseve digjital, është është në format të përgjithshëm. Me transmetimin e saj digjital, hapësira e transmetimit në maqedoni nuk do të pasurohet me shërbim të ndryshëm ose specifik, dhe as

peizazhi mediatik do të fitojë vlerë të re. Nëse do të ishte televizion me format të specializuar, pa asnjë hezitim do të mbështesja shpalljen e një konkursi të tillë.

- Mbulimi i lartë përmes platformave ekzistuese: Nga ana tjetër, TV 24 Vesti nuk pëson humbje për shkak të mostransmetimit tokësor (digjital), pasi Maqedonia ka depërtim dhe disponueshmëri jashtëzakonisht të lartë të shërbimeve kabllore dhe të internetit.

Sipas të dhënave zyrtare nga "Raporti mbi zhvillimin e tregut të komunikimeve elektronike në tremujorin e tretë të vitit 2025", nga gjithësej 598.632 familje në vend, qasje në shërbimet televizive përmes operatorëve kanë deri 442.180. Kjo do të thotë se mbi 74% e familjeve kanë qasje në transmetimet televizive përmes rrjeteve kabllore dhe IPTV (të cilat paraqesin burim të pakufizuar, siç është aktualisht rasti) dhe me "TB 24 Vesti".

Këshilltarja Cvetanka Minovska shprehu mirënjohjen e saj ndaj shërbimit profesional të Agjencisë për Studimin e përgatitur profesionalisht, duke e vlerësuar analizën si gjithëpërfshirëse dhe të argumentuar. Bazuar në gjetjet dhe konkluzën e përfshirë në Studim, vuri në dukje se do të mbështesë propozimin për refuzimin e Kërkesës.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga deklaroi se do të votonte kundër shpalljes së konkursit publik, duke vlerësuar se gjendja e tregut mediatik nuk e justifikon nevojën për shërbim të ri televiziv me format të përgjithshëm. Ajo theksoi se trendet bashkëkohore i referohen zhvillimit të kanaleve televizive të specializuara, të cilat mungojnë në tregun mediatik vendas.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin refuzoi Kërkesën me shkrim të palës së interesuar, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive 24 Vesti ShPKNJ P Shtip, nr. ark.03-67/1 të datës 5.2.2020 (PA1 nr.y në 08-55 të datës 11.2.2020) me plotësimet nr.ark.03-958/2 të datës 21.9.2020. (PA1 nr ynë.08-94 të datës 22.9.2020) , për shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv të shërbimi programor me format të përgjithshëm kryesisht informues ose format të përgjithshëm me tre funksione mediatike (informues, edukativ dhe argëtues), në nivel shtetëror, përmes multipleksi digjital tokësor, për shkak të faktit se Studimi për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksi digjital tokësor (nr ark.08-2339/1 të datës 3.6.2026), u përcaktua se nuk ka arsye për shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes së re për shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksi digjital tokësor .

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 4

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi Propozim-vendimin për të lejuar ndryshim në strukturën pronësore të ShTR Jon Radio ShPK Strugë. Ai shpjegoi se transmetuesi kryen transmetim në radio në nivel shtetëror dhe se në strukturën pronësore ekzistuese janë pjesëmarrës dy persona fizik. Me ndryshimin e propozuar, personi fizik Fisnik Tateshi tërhiqet nga struktura pronësore, ndërsa personi fizik Goce Stojkovski do të bëhet pronari i vetëm me 100% pjesëmarrje. Drejtori informoi se, pas kontrolleve të kryera nga sektorët kompetente të Agjencisë, u përcaktua se ndryshimi i propozuar nuk shkel dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale që i referohen përqendrimit të paautorizuar mediatik. Prandaj, ai propozoi që Këshilli të miratojë vendim me të cilin miratohet ndryshimi në strukturën pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Jon Radio ShPK Strugë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilën lejon ndryshim në strukturën pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Jon Radio ShPK Strugë, me tekstin siç është propozuar në vendim.

Me ndryshimet e propozuara në strukturën pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Jon Radio ShPK Strugë nuk paraqitet përqendrim i paautorizaur mediatik në aspekt të LShMAAV-së, përkatësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 të LSHMAAV-së.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive Jon Radio ShPK Strugë është e detyruar të zbatojë ndryshim në strukturën pronësore në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 90 ditësh nga dita e miratimit të Vendimit të lartpërmendur. Nëse ndryshimi nuk zbatohet në afatin e caktuar, vendimi do të anulohet.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin me të cilin lejohet ndryshim në strukturën pronësore të ShTR Jon Radio ShPK Strugë ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 5

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, arsyetoi Informacionin në lidhje me donacionin e dhënë ISHP SBGMP 13 Nëntori Shkup, me Propozim – aneks nr.1 ndaj Kontratës për donacion. Ai kujtoi se Këshilli në njërën nga seancat e mëparshme miratoi Vendim për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës për donacion, sepse institucioni shëndetësor nuk e realizoi donacionin në afatin e parashikuar dhe nuk paraqiti dokumentacion përkatës për realizimin e tij. Pas dorëzimit të propozimit për ndërprerjen me marrëveshje të kontratës, institucioni shëndetësor paraqiti shkresë të re duke kërkuar zgjatje të afatit për realizimin e donacionit deri në maj 2027. Duke marrë parasysh kërkesën e paraqitur, si dhe qëndrimet e shprehura nga anëtarët e Këshillit në seancën e mëparshme, Drejtori propozoi të pranohet zgjatja e afatit për realizimin e donacionit dhe të bëhet Aneks marrëveshje nr.1 ndaj Kontratës për donacion.

Këshilltarja Cvetanka Minovska deklaroi se do ta mbështeste propozimin, duke marrë parasysh nevojat e shfrytëzuesve të shërbimeve të këtij institucioni shëndetësor. Ajo theksoi se është e nevojshme që në Aneks marrëveshjen të përcaktohet saktësisht afati për realizimin e donacionit, përkatësisht maj 2027, në përputhje me kërkesën e institucionit, me qëllim që të shmangen kërkesat e ardhshme për zgjatje shtesë të afatit.

Drejtori Trajčevski sqaroi se nëse Këshilli e pranon Informacionin, do të jetë e nevojshme të bëhet Aneks nr.1 ndaj Kontratës për donacion, në të cilën saktësisht do të përcaktohet afati përfundimtar për realizimin e donacionit.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, propozoi që në Aneks të përcaktohet afati i cekur në shkresën e institucionit shëndetësor, duke vlerësuar se Agjencia duhet të tregojë vullnet të mirë dhe të mundësojë realizimin e donacionit në kuadër të afatit të kërkuar.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli pyeti nëse për vazhdimin e afatit për realizim dhe lidhjen e aneks marrëveshjes do të njoftohen dhe Drejtoria (zyra) e të Ardhurave Publike dhe Ministria e Drejtësisë.

Drejtori Trajčevski u përgjigj se për ndryshimin e afatit për realizimin e donacionit me kohë do të njoftohen dhe Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Ministria e Drejtësisë.

Këshilli i Agjencisë pranoi Informacionin nr.03-2106/4 të datës 8.6.2026 në lidhje me donacionin e dhënë për ISHP SGBMP 13 Nëntori Shkup, me propozim – Aneks marrëveshje nr.1 ndaj Kontratës për donacion, dhe njëzëri miratoi që drejtori i Agjencisë të nënshkruaj Aneks marrëveshje nr.1 për dhënien e ndihmës financiare - donacion të datës 11.02.2025, të lidhur midis ASHMA-së dhe Institucionit Publik Shëndetësor - Spitali i Specializuar për Mjekësi Paliative Geriatrike "13 Nëntori" Shkup, me tekstin e propozuar.

Të njoftohet Ministria e Drejtësisë së RMV-së dhe Drejtoria e të Ardhurave Publike për Aneks marrëveshjen nr.1 për dhënien e ndihmës financiare - Donacion të datës 11.02.2025.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit - byro përkthimi. Ajo theksoi se lëndë e furnizimit janë shërbimet për përkthim me gojë dhe me shkrim nga gjuha maqedone në anglisht, gjermanisht, frëngjisht dhe shqip dhe anasjelltas, në përputhje me nevojat e Agjencisë. Ajo shpjegoi se shërbimet e përkthimit me shkrim do të përdoren për përkthimin e materialeve të punës, dokumenteve, studimeve, analizave dhe akteve të tjera të përgatitura nga Agjencia, ndërsa shërbimet e përkthimit simultan dhe konsektiv do të përdoren gjatë organizimit të eventeve, takimeve, konferencave, punëtorive dhe aktiviteteve të tjera të organizuara nga Agjencia. Furnizimi është parashikuar në Planin Vjetor për furnizime publike të Agjencisë për vitin 2026, ndërsa mjete janë siguruar në Planin Financiar të Agjencisë për të njëjtin vit. Sipas vlerës së parashikuar, procedura do të zbatohet si furnizim me vlerë të ulët, në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizime publike që lidhen me këtë lloj procedure. Ajo vuri në dukje se të gjitha informacionet dhe detajet e tjera në lidhje me furnizimin janë të përfshira në materialet e paraqitura për këtë pikë të rendit të ditës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: byro përkthimi.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik-shërbim: byro për përkthim, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, (tekst i pastruar) nr.05-2219/1 i datës 22.5.2026, dhe fondet janë parashikuar në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026, përkatësisht do të parashikohen në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2027.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të lëndës për furnizim - mallra: pije dhe furnizime kuzhine. Ajo shpjegoi se furnizimi është parashikuar në Planin Vjetor për furnizime publike të Agjencisë për vitin 2026, dhe mjetet (fondet) e nevojshme janë siguruar në Planin Financiar të Agjencisë për të njëjtin vit. Në përputhje me vlerën e parashikuar, kemi të bëjmë me furnizim me vlerë të ulët, i cili do të zbatohet përmes tregut elektronik për furnizim me vlerë të ulët në kuadër të Sistemit Elektronik për furnizime publike. Gjithashtu theksoi se bëhet fjalë për mjet relativisht i ri i parashikuar nga sistemi për furnizime publike, të cilin Agjencia do ta përdorë për herë të parë. Të gjitha informacionet dhe detajet e tjera që lidhen me furnizimin në fjalë përmbahen në materialet e paraqitura për këtë pikë të rendit të ditës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik-mallra: pije dhe furnizime kuzhine.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik-mallra: pije dhe furnizime kuzhine është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, (teksti i pastruar) nr.05-2219/1 të datës 22.5.2026, dhe fondet janë parashikuar në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 8

Të ndryshme

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi Propozim-rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për mënyrën e shfrytëzimit, manaxhimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Ai shpjegoi se në periudhën e ardhshme Agjencia do të marrë dy automjete të reja zyrtare, prandaj është e nevojshme të bëhen ndryshime dhe plotësime përkatëse në Rregulloren ekzistuese. Ai theksoi se pjesë përbërëse e Rregullores është rishikimi i automjeteve zyrtare të Agjencisë, ku renditen edhe targat e regjistrimit të automjeteve. Meqenëse aktualisht Agjencia nuk disponon me targat e regjistrimit të automjeteve të reja, propozohet ndryshim me të cilin ky rishikim do të mund të përditësohet me propozim nga udhëheqësi i sektorit kompetent për automjetet zyrtare, pa pasur nevojë për ndryshime shtesë në Rregullore sa herë që ka ndryshim të targës së regjistrimit, blerje të një automjeti të ri ose mospërdorimin(largimin) e automjetit ekzistues. Në të njëjtën kohë, drejtori theksoi se është e nevojshme në Rregullore të plotësohet dispozita e cila parashikon që Agjencia disponon dhe me automjete të siguruar përmes lizingut operativ, në mënyrë që automjetet e reja të mund të përdoren në përputhje me dispozitat e Rregullores.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për mënyrën e përdorimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me tekstin siç është propozuar.

Akti nënligjor i lartpërmendur hyn në fuqi ditën e miratimit të tij dhe publikohet në tabelën e njoftimeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për mënyrën e përdorimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së Automjeteve zyrtare të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë tekst të rishikuar për aktin nënligjor të lartpërmendur.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani